

**OSHEE GROUP sh.a** njofton mbi hapjen e vendit vakant **Shef Sektori** pranë OSSH / Departamenti i Matjes dhe Mbështetjes së Tregut / Drejtoria e Raportimit, Parashikimit dhe Llogaritjes së Humbjeve / Sektori i Bilancit Energjistik dhe Përlllogaritjet.

## **SHEF SEKTORI**

Shefi i Sektorit të Bilancit Energjistik dhe Përlllogaritjet është drejtues dhe mbikqyrës i një tërësi procesesh të përqëndruara për të ndihmuar që Bilanci Energjistik dhe raportet e tjera komplementare të japin nje paraqitje te qartë të performancës të rrjetit nga këndvështrimi humbjeve dhe të ndihmojë dhe orientojë veprimet për arritjen e objektivave mujore dhe vjetore.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Organizon dhe mbikëqyr proceset e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave për bilancin energjistik dhe raportet përkatëse.
- Harton dhe analizon bilancin energjistik, humbjet sipas niveleve të tensionit dhe zonave të shpërndarjes, si dhe raporte të specializuara (fidera, kabina, TL/TM/TU).
- Siguron saktësinë dhe rakordimin e të dhënave ndërmjet burimeve të ndryshme dhe strukturave përkatëse.
- Monitoron realizimin e objektivave mujore dhe vjetore të humbjeve dhe analizon performancën e rajoneve shpërndarëse.
- Përgatit raporte periodike për institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për drejtuesit e shoqërisë.
- Kryen analiza për identifikimin e mundësive për uljen e humbjeve dhe vlerëson ndikimin e investimeve në rrjet.
- Organizon dhe mbikëqyr aktivitetin e stafit, duke siguruar zhvillimin e tyre profesional dhe rritjen e efikasitetit të proceseve.
- Bashkëpunon me strukturat e tjera për realizimin e proceseve dhe ndjek problematikat në terren, duke ofruar zgjidhje.
- Ndjek dhe zbaton kërkesat e legjisllacionit dhe kuadrit rregullator në sektorin e energjisë.
- Raporton periodikisht mbi ecurinë e proceseve dhe realizimin e objektivave.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

### **Kualifikimet dhe kërkesat:**

- Diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike, Elektroteknikë, Energjetikë ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë pune ne sektorin energjistik përbën avantazh.

- Njohuri të avancuara në analizën e të dhënave dhe modelimin e rrjeteve elektrike (preferohet eksperiencë me programe si DigSilent ose të ngjashme).
- Njohuri të mira të legjislacionit dhe kuadrit rregullator në sektorin e energjisë.
- Aftësi shumë të mira analitike dhe raportuese.
- Aftësi menaxheriale, organizative dhe koordinuese.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional.
- Njohuri të mira të paketës Microsoft Office.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.